

Shëndeti psiqik

Në Zvicër nuk bëhet dallim në mes sëmundjeve psiqike dhe fizike. Sigurimi bazë e paguan trajtimin e sëmundjeve psiqike te njerëzit e specializuar si dhe qëndrimin në klinik.

Mbështetja dhe këshillimi

Për situata të vështira personale apo familjare ka në Zvicër shumë persona të specializuar të cilët ndihmojnë më tej. Sigurimi bazë (Grundversicherung) e paguan trajtimin te sëmundjet psiqike te njerëzit e specializuar të çertifikuar me ligj si psikiatret dhe psikiatrit. Qëndrimet në klinik po ashtu paguhen. Kush ka probleme, mundet falas me ju drejtue këshillimoreve anonime. Kështu këshillon Dora e Zgatur (Dargebotene Hand) përmes telefonit, E- Mailt apo chat (telefon 143, www.143.ch). Mirëpo edhe mjekja apo mjeku familjar munden të ndihmojnë. Kur një person është akut i rrezikuar, që vetes apo tjetrit mund t'i bëjë diçka duhet të veprohet shpejt. Në këto raste urgjente ndihmon policia (telefoni 117).

Fëmijët dhe të rinjët

Për të rinjët me probleme psiqike është falas si hap i parë i mirë shërbimi psikologjik për të rinjë (Jugendpsychologischer Dienst). Edhe prindërit, të cilët brengosen për fëmijët e tyre, munden me u lajmëruë aty. Mbështetje anonime falas për fëmijë dhe të rinjë ofrojnë thirrja emergjente për fëmijë (Kindernotruf) përmes telefonit, E-Mal apo Chat (Tel.147, www.147.ch). Për raste emergjente psikiatrike te fëmijët dhe të rinjët është ambulanca qendrore për fëmijë dhe të rinjë (ZAJK) përgjatë 24 orëve në dispozicion nën numrin e telefonit 056 62 21 20.

Sëmundjet e vesit

Te sëmundjet e vesit ndihmojnë qendrat këshilluese për vese të këshillimit për vese ags (Suchtberatung ags) dhe qendra këshilluese rajoni i Badenit (Beratungszentrum Bezirk Baden) më tutje. Këto vende ofrojnë mbështetje dhe këshillim në besim falas. Edhe kur njeriu brengoset për për të afërmit dhe personave që ka pranë, mundet t'i kontaktoj qendrat këshilluese. Këto ofrojnë këshillime edhe në disa gjuhë të huaja. Te sëmundjet e vesit nuk numrojnë vetëm vesi i alkoholit-apo drogës. Edhe te veset e tjera si vesi i lojës, i blerjes apo internetit edhe te pengesat në të ngren ndihmojnë këshillimoret e vesit tutje. Pyetjet mund të bëhen edhe përmes mailit.

Traumatizimi

Kush në jetë përjeton gjëra të këqija dhe nuk mundet t'i harroj, duhet të marr mbështetje. Sepse traumatizimet janë sëmundje që duhet marr seriozisht. Përgjatë këshillimit dhe ofertave mbështetëse për probleme psiqike dhe sëmundje ka edhe vende me njerzë të specializuar për trajtime të viktimave të luftës dhe torturës.

[Më shumë informacione \(link, adresa, broshura, fletushka\)](#)

www.hallo-aargau.ch/sq/shendeti/shendeti-psiqik